

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK SHKODËR

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit
Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjelle nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar, dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen, apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqërie rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve(UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lart të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA duhet të hartohet me të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke pasur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave të Matje të Pavarura (DMA-te), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

Shoqëria rajonale UK Shkodër përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Shkodër, UK Fushë Arrëz, UK Pukë, UK Vau i Dejës dhe UK Malësia e Madhe. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Shkodër jepen në tabelën 1.

Nga të dhënat e Tabelës 1, vërehet se dy ish shoqëri të shoqërisë rajonale Shkodër kanë probleme me faturimin me matje si njësia Vau i Dejës 66.4 l/ditë, banor dhe njësia Malësi e Madhe 73.7 l/ditë, banor duke pasur parasysh normën mesatare, tashmë të pranueshme për të gjithë sektorin, prej 100 l/ditë, banor.

Probleme me faturimin aforfe rezultuan tek të gjitha njësitë e shoqërisë Rajonale. Njësia Shkodër (205 l/ditë, banor), njësia Vau i Dejës (140.1 l/ditë, banor) dhe njësia Malësia Malësia e Madhe (194.6 l/ditë, banor) të cilat janë në nivele më të larta se 150 litra/banor në ditë dhe duhet të analizojë arsyet e mbi faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktivë). Ndërsa njësitë Fushë Arrëz (80.7 l/ditë, banor) dhe Pukë (65.1 l/ditë, banor), të cilat janë në nivele më të ulëta si të papranueshme referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Shoqëria Rajonale UK Shkodër	Popullsia e Shërbyer	Konsumi Total (në m ³)	Konsumi i Matur (në m ³)	Konsumi Pamatur (në m ³)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi (l/ditë, banor)		
							Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
Shkodër	68,570	3,244,000	1,732,000	1,512,000	20,920	8,742	98.1	205.0	129.6
Fushë Arrëz	2,991	132,300	86,400	45,900	375	408	165.2	80.7	121.2
Pukë	5,669	180,671	159,234	21,437	1559	295	91.5	65.1	87.3
Vau Dejës	11,770	305,044	267,597	37,447	2,759	183	66.4	140.1	71.0
Malësi e Madhe	18,874	695,692	392,916	302,776	4,646	1,355	73.7	194.6	101.0
Totali	107,874	4,557,707	2,638,147	1,919,560	30,259	10,983	91.3	183.1	115.8

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Shkodër	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimit (m ³ /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)				(l/ditë, banor)
Shkodër	68,570	12,045,184	129.6	119,668	34,525,440	790.4	+660.8
Fushë Arrëz	2,991	202,000	121.2	6,854	371,000	148.3	+27.1
Pukë	5,669	256,910	87.3	9,654	1,302,848	369.7	+282.4
Vau Dejës	11,770	836,000	71	26,544	4,515,400	466.1	+395.0
Malësi e Madhe	18,874	1,203,100	101	26,444	9,213,166	954.5	+853.5
Totali	107,874	14,543,194	115.8	189,164	49,927,854	723.1	+607.4

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2, shihet se shoqëria rajonale UK Shkodër ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit se ka një sasi të disponueshme 723.1 l/ditë, banor kur konsumi total i matur dhe aforfe është 115.8 l/ditë, banor. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të tyre, duke u bazuar në prodhimin sipas

kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Shkodër

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Shkodër ka prodhuar 12,045,184 m³ ujë të prodhuar **100% e vlerësuar, pasi mungojnë matësat në burime** Raportohen **33,166** lidhje uji prej të cilave **23,908** lidhje ose **72.1%** janë me matje. Shërbimin e furnizimit me ujë e marrin rreth **57.3 %** të popullsisë në juridiksion.

“UPA” rezulton në nivelin 68.96%. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë është pjesërisht i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në tabelën 3, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Shkodër.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Shkodër- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	12,045,184	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,156,287	17.90%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,582,604	13.14%
Faturimi Total	3,738,891	31.04%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	48,825	0.41%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,202,205	9.98%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	2,200,000	18.26%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,130,000	9.38%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	4,532,205	37.63%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	910,513	7.56%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	264,000	2.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	203,629	1.69%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	2,316,755	19.23%
Humbjet e ujit nga riparimet ne linjat e sistemit të Ujësjellësit	30,366	0.25%
Humbjet Reale (Teknike)	3,725,263	30.93%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	8,257,468	68.55%
UJI PA TË ARDHURA	8,306,293	68.96%

Komente :

- Treguesi i UPA në nivelin 68.96% konsiderohet mjaft i lartë dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.

- Niveli i humbjeve reale është 30.93%, ku shihet që pjesën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 19.23% dhe në rrjetin e transmetimit 7.56%, shifra të cilat konsiderohen të larta.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 23,908 klientë dhe përbëjnë 72.1% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Konsumi i faturuar është 31.04%, prej të cilit vetëm 17.9% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 37.63% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim në nivelin 9.98% dhe shpërndarje në nivelin 18.26% të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 9.38%, i cili konsiderohen të larta.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar sepse nuk ka matësa në prodhim, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht të treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke pasur parasysh që asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marr masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 30.93%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 19.23% dhe në rrjetin e transmetimit 7.56%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike të përkeqësuar të rrjetit, të vlerësohen evidencat frekuencave (sa shpesh) të riparimeve të defekteve (çarje) që ndodhin gjatë vitit të linjave të transmisionit dhe të shpërndarjes.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 9.38% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësave, a janë të pajisur me ujëmatës shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale etj.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Fushë-Arrëz

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Fushë Arrëz ka prodhuar 202,000 m³ ujë, **i cili 100% është i matur**. Raportohen 783 lidhje uji prej të cilave 375 lidhje ose 47.9% janë me matje. Shërbimin e furnizimit me ujë e marrin 2,991 banor ose 53.6 % të popullsisë në juridiksion.

“UPA” rezulton në nivelin 34.5%. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike. Në tabelën 4, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Fushë Arrëz.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Fushë-Arrëz – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	202,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	86,400	42.77%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	45,900	22.72%
Faturimi Total	m³	132,300	65.50%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	m³	5,000	2.48%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	m ³	4,700	2.33%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	10,000	4.95%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	5,000	2.48%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	m³	19,700	9.75%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	5,500	2.72%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	3,000	1.49%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	m ³	3,000	1.49%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	m ³	32,000	15.84%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjesit	m ³	1,500	0.74%
Humbjet Reale (Teknike)	m³	45,000	22.28%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	m³	64,700	32.03%
UJI PA TË ARDHURA	m³	69,700	34.50%

Komente :

- UPA në nivelin 34.5% të prodhimit vjetor.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i matur.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 375 klientë dhe përbëjnë 47.9% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Konsumi i faturuar është 65.5%, prej të cilit 42.77% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Konsumi i autorizuar i pa faturuar është 2.48%, ndërkohë që Shoqëria duhet të konsumojë për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

- Niveli i humbjeve reale është 22.28%, ku shihet që pjesën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 18.56%.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 9.75% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe në shpërndarje në nivelin 7.28% të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 2.48%, konsiderohet i mirë.

Rekomandime:

- Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 22.28%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (15.84%), duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike të përqësuar të rrjetit, të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca të cilat vërtetojnë defektet (çarje) mjaft të shpeshta që ndodhin gjatë vitit të rrjetit shpërndarës, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose nga vetë shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.
- Duke pasur parasysh që të gjithë burimet e shfrytëzueshme nga shoqëria janë me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës do të jetë vetëm për klientët familjare pasi vetëm 301 lidhje ose 38.4% e lidhjeve totale, janë të pajisur me matës. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e fondeve për pajisjen e të gjithë klientëve me matës.
- Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Pukë

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Pukë ka raportuar sasinë e ujit të prodhuar sipas një sistemi me vet rrjedhje prej 256,910 m³ ujë, **i cili rezulton 39% i matur**, pjesa tjetër vlerësohet.

Shërbimi i FU ofrohet për rreth 58.7% të popullsisë në juridiksion, si dhe raportohet se 1,854 lidhje uji, prej të cilave 1,559 lidhje ose 84% janë të pajisur me ujëmatës.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 29.09%, vlerë e cila nuk duket e besueshme dhe që duhet bërë verifikime të thelluara për vërtetësinë e saj. Kjo shoqëri ka avantazhi se i gjithë prodhimi i ujit nga burimi realizohet me rrjedhje të lirë.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar me zona të pavarura me matje (DMA).

Në Tabelën 5, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Pukë.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Pukë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	256,910	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	159,234	61.98%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	21,437	8.34%
Faturimi Total	180,671	70.32%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	1,500	0.58%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	3,000	1.17%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	3,910	1.52%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	17,200	6.69%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	24,110	9.38%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	9,500	3.70%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	1,000	0.39%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	2,000	0.78%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	37,500	14.60%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	629	0.24%
Humbjet Reale (Teknike)	50,629	19.71%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	74,739	29.09%

Komente :

- UPA në nivelin 29.09 % të prodhimit vjetor, që duket si vlerë jo e besueshme që duhet verifikuar.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 39 % i matur, pjesa tjetër i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 1,559 klientë dhe përbëjnë 84% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Konsumi i faturuar është 70.32%, prej të cilit 61.98% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 19.71%, ku shihet që pjesën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe në rrjetin shpërndarës 18.3%, pjesa tjetër e komponentëve janë në vlera të vogla më pak se 1%, vlera që kërkojnë verifikime të metejshme.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 9.38% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga pasaktësia në matje, nën faturim në vlerën 6.69%, ndërsa humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe në shpërndarje në nivelin 2.69% të prodhimit vjetor duken jo të besueshme.

Rekomandime:

- Duke pasur parasysh që vetëm 39% e ujit që duhet për furnizimin me ujë të zonës së shërbimi është i matu , nevoja për investime në matësa në prodhim është e domosdoshme. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.

- Pasaktësia e mundshme gjatë përlogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se jo të gjitha burimet janë të pajisura me matës dhe vetëm 39% e ujit matet, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.
- Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve dhe menaxhimin më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë.
- Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 14.6%, duhet të verifikohen nëse janë të sakta, nëse po, të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale që të reduktohen UPA.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të pajisur të gjithë klientët me matës edhe pse 84.3% e klientëve familjar janë me matës, që të bëjë të mundur një faturim sipas një konsumi real për klientët.
- Duke pasur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Të saktësohen sasia e ujit të prodhuar që raportohet tek ERRU pasi sipas bilancit të ujit është 256,910 m³ ujë ndërsa tek të dhënat e sektorit të monitorimit është 740,000 m³ ujë, pothuajse 3 herë më e lartë.

II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Vau-Dejës

Në Njësinë Administrative Vau i Dejës ka në zonën e saj të juridiksionit 26,544 banorë, ku shërbimin e FU ofrohet për 11,770 banorëve ose 44.3% të kësaj popullsie. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë 836,000 m³ ujë, prej të cilit **58% është i matur**, pjesa tjetër i vlerësuar. Treguesi i UPA reshte në nivelin 63.51%, ndërsa Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 36.49%, prej të cilit 32% është i matur.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë është 2,942 lidhje, nga të cilat 2,759 lidhje ose 93.7% janë me matës, ndërsa pjesa tjetër aforfe.

Në Tabelën 6, paraqitet Bilancit të Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Vau i Dejës

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Vau-Dejës – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (ne m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	836,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	267,597	32.01%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	37,447	4.48%
Faturimi Total	305,044	36.49%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	3,000	0.36%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	52,400	6.27%

Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	126,131	15.09%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	48,620	5.82%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	227,151	27.17%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	59,750	7.15%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	20,779	2.49%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	26,450	3.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	188,462	22.54%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	5,364	0.64%
Humbjet Reale (Teknike)	300,805	35.98%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	527,956	63.15%
UJI PA TË ARDHURA	530,956	63.51%

Komente :

- Treguesi i UPA në vlerën prej 63.51% të prodhimit vjetor është papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 58 % i matur.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 2,759 klientë dhe përbëjnë 93.7% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Konsumi i faturuar është 36.49%, prej të cilit 32% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 27.17% vjen nga lidhjet e paligjshme në transmetim (6.27%) dhe në shpërndarje (15.09%), si dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim janë në nivelin 5.82%.
- Niveli i humbjeve reale është 35.98%, i përberë nga humbjet nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 7.15% dhe ato në rrjetin shpërndarës 22.54%.

Rekomandime:

- *Duke pasur parasysh që vetëm 58% e ujit që duhet për furnizimin me ujë të zonës së shërbimi është i matur, paraqitet e domosdoshme nevoja për investime në ujëmatës në prodhim. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se jo të gjitha burimet janë të pajisura me matës dhe vetëm 58% e ujit matet, e ben jo shume te besueshme vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar.*
- *Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve dhe menaxhimin më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 22.54% duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, nëse po, të planifikohen fonde për rehabilitimin e tyre për te reduktuar UPA.*

- Duke pare vlerën e larte prej 21,6% nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe në atë shpërndarës, duhet të saktësohet baza e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-force) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-se, si edhe me verifikime në vend lidhje dytësorë.
- Duke pasur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i ish shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.

II.5 UPA për Ish Shoqërinë UK Malësi e Madhe

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Malësi e Madhe ka në zonën e saj të juridiksionit 26,444 banor, ku shërbimi i FU i ofrohet 18,874 banorëve ose 71.4% të kësaj popullsie. Prodhimi vjetor i raportohet 1,203,100 m³ ujë që **rezulton 100% i vlerësuar** sepse mungojnë matësat në burim.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë është 6,001 lidhje, nga të cilat 4,646 lidhje ose 77.4% janë me matës, ndërsa pjesa tjetër aforfe.

Konsumi i faturuar i realizuar rezulton në nivelin 57.82% të prodhimit prej të cilit 32.66% është i matur. “Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 42.18%.

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 7, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Malësi e Madhe.

Tabela 7. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Malësi e Madhe – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të Prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	1,203,100	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	392,916	32.66%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	302,776	25.17%
Faturimi Total	m³	695,692	57.82%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	m³	3,160	0.26%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	m ³	24,110	2.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	35,800	2.98%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	108,110	8.99%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	m³	168,020	13.97%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	78,700	6.54%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	21,770	1.81%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	m ³	28,610	2.38%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	m ³	205,994	17.12%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	m ³	1,154	0.10%
Humbjet Reale (Teknike)	m³	336,228	27.95%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	m³	504,248	41.91%
UJI PA TË ARDHURA	m³	507,408	42.18%

Komente :

- UPA është në nivelin 42.18% të prodhimit vjetor.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 4,646 klientë dhe përbëjnë 77.4% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Konsumi i faturuar është 57.82%, prej të cilit 32.66% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Konsumi i autorizuar i pa faturuar është me pak se 1%.
- Niveli i humbjeve reale është 27.95%, ku shihet që pjesën më të madhe e zënë humbjet që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 17.12% dhe në rrjetin e transmetimit 6.54%.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 13.97% që vlerësohet se pjesa më e madhe prej 8,99% vjen nga pasaktësia në matje, nën faturim, si dhe 4,98% nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje, shifra këto të fundit që duhen verifikuar për të qenë të besueshme.

Rekomandime:

- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 27.95%, nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe në rrjetin shpërndarës 23.66%, shoqëria duhet të evidentojë nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, nëse po, të merren masa me fondet përkatëse nga pushteti qendror ose vetë shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturim në nivelin 8.99% duhet të thellohet analiza për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturim duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësive, a janë të pajisur me ujëmatësa shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale etj.*
- *Duke pasur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i ish shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

Shoqëria Rajonale UK Shkodër, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Kjo shoqëri ka në juridiksion **189,164 banor**.

Shërbimin i FU i ofrohet **107,874 banorëve** ose **57%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet **44,746 lidhje**, nga të cilat **33,247 lidhje** ose **74.3%** janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **14,543,194 m³ rezulton i matur në nivelin 5.4%**, sepse përgjithësisht mungojnë matësat në burime.

UPA është në nivelin 65.26% të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon vetëm **5,052,598 m³ ujë** ose **34.74%** të prodhimit.

Tabela 8, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Shkodër.

Tabela 8. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	14,543,194	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,062,434	21.06%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,990,164	13.68%
Faturimi Total	5,052,598	34.74%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	61,485	0.42%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,286,415	8.85%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	2,375,841	16.34%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,308,930	9.00%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	4,971,186	34.18%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	1,063,963	7.32%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	310,549	2.14%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	263,689	1.81%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	2,780,711	19.12%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	39,013	0.27%
Humbjet Reale (Teknike)	4,457,925	30.65%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	9,429,111	64.84%
UJI PA TË ARDHURA	9,490,596	65.26%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 65.26% të prodhimit vjetor, i cili është sa mesatarja e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet mjaft e lartë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes prej 5.4% për “Uji i prodhuar” i bën jo të besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.

- Konsumi total i faturuar është në nivelin 34.74%, prej të cilit 21.06% është konsum i faturuar i pamatur.
- Numri i klientëve me matës prej 74.3% të totalit të klientëve nuk është i pranueshëm për një menaxhim korrekt të Kërkesës për Ujë duhet të jetë sa më afër 100%.
- Numri i Klientëve familjar me matës është 29,520 klientë ose 89% e totalit të klientëve me matës.
- Niveli i humbjeve reale është 30.65% që vijnë nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe në rrjetin e transmetimit në nivelin 26.44%, si dhe rrjedhjet në stacionet e pompimit dhe në depo në nivelin 3.95%. Duhet verifikuar vlera prej më pak se 1% e humbjeve për shkak të riparimeve për të qenë vlerë e besueshme.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 34.18 % nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 25.19 % , dhe 9% nga pasaktësia në matje, nën faturim, konsiderohen të larta.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafi i shoqërisë për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit

Rekomandime:

- *Duke pasur parasysh që vetëm 5.4% është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Duke qenë vetëm 5.4% e ujit matet, vihet në dyshim vërtetësia e vlerës së volumit të ujit të prodhuar dhe të vlerave të të gjithë komponenteve të Bilancit të ujit.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, evidentim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të rrisë përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që aktualisht është 89%, me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 30.65%, shoqëria duhet të japë argumente të mëtjetshme për justifikimin e tyre, të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit të planifikohen fonde për rehabilitimin e tyre që do të reduktonte UPA.*

- *Për të justifikuar vlerën prej 9% të humbjeve nga pasaktësia në matje, Shoqëria duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku arsyeja reale e tyre, tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve etj.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet të referohet problematikes në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore, klientë pa kontratë, kontroll të punës së lexuesve të matësve etj.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të pasur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkoet.*
- *Të trajtojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërinë rajonale, duke filluar me vitin 2023, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara*